

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga GALENIKA SHA. BEOGRAD me seli të regjistruar në rr. Batajnički drum pn, Beograd – Zemun, Serbi, të dorëzuar përmes Andrea Llazarevska, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 24.11.2025, solli këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin shoqëria GALENIKA SHA. BEOGRAD me seli të regjistruar në rr. Batajnički drum pn, Beograd – Zemun, Serbi, do të fitojë kontroll të plotë mbi Sanofarm d.o.o., me seli të regjistruar në Industrijska 6r, 6310 Izola, Slloveni, përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse bën pjesë në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e dukshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Obligohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin për përqendrim në shumën prej 6.000,00 den. dhe për vendimin në shumën prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3. Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji), më datë 22.10.2025, dhe plotësuar më datë 29.10.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga ana e GALENIKA AD. BEOGRAD me seli të regjistruar në rr. Batajnički drum pn, Beograd – Zemun, Serbi, me të cilin GALENIKA SHA. BEOGRAD do të fitojë kontroll të plotë mbi Sanofarm d.o.o., me seli të regjistruar në Industrijska 6r, 6310 Izola, Slloveni, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

-GALENIKA SHA. BEOGRAD është themeluar në vitin 1945, ndërsa nga viti 2017 është pjesë e Grupit brazilian NK. Veprimtaria mbizotëruese e GALENIKA SHA. BEOGRAD është

prodhimi i preparateve farmaceutike, më së shpeshti barnave që lëshohen me recetë. Një pjesë më e vogël e asortimentit të GALENIKA SHA. BEOGRAD përfshin produkte që mund të lëshohen pa recetë mjekësore, si dhe produkte të caktuara të destinuara për përdorim në ordinancë profesionale stomatologjike.

Markat më të rëndësishme të shoqërisë GALENIKA SHA. BEOGRAD janë: Palitrex, Bensedin, Ksalol, Spironolakton, Diklofen, Dexason, Sinacilin, Pantenol, Oligovit, Biogal, Flourogal dhe shumë të tjera.

Shoqëria GALENIKA SHA. BEOGRAD procesin e prodhimit të produkteve farmaceutike e kryen në pesë reparte të veçanta prodhimi, kapaciteti i përgjithshëm vjetor i prodhimit të së cilave është rreth 81 milionë paketime. Të gjitha repartet e prodhimit gjenden në Serbi.

GALENICA SHA. BEOGRAD ka përfaqësi në Maqedoninë e Veriut, edhe atë: **GALENICA SH Beograd, Serbi – PËRFAQËSIA SHKUP** me seli të regjistruar në bulevardin Koço Racin 14, Shkup dhe me veprimtari prioritare – hulumtimi i tregut dhe shqyrtimi i mendimit publik, si dhe **Shoqëria për shërbime GALENIKA SHPKNJP Shkup** me seli të regjistruar në bulevardin Koço Racin 14, Shkup – Qendër dhe me veprimtari prioritare – hulumtime dhe zhvillim eksperimental në shkencat shoqërore dhe humaniste.

GALENICA SHA. BEOGRAD është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut me produktet e saj të cilat i distribuon përmes tregtarëve lokalë me shumicë të barnave.

-**Sanofarm d.o.o.** është kompani sllovene e cila merret me import dhe shpërndarje të preparateve natyrore – suplemente dietike nga prodhuesit nga Italia, Pharnalife Research srl dhe ESI srl. Sanofarm d.o.o. është importues dhe distributor ekskluziv i preparateve të këtyre prodhuesve për Slloveninë dhe Kroacinë.

Sanofarm d.o.o. nuk ka shoqëri të varura ose përfaqësi në Maqedoninë e Veriut, dhe as nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me tregun e tregtisë me shumicë të produkteve farmaceutike që lëshohen pa recetë mjekësore (produkte OTC) në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i përmbush kushtet nga neni 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e dukshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh një vlerësim të këtillë të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e prolongon ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ